



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 26/11

Prishtinë, më 06.09.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Duda Balje, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Naser Osmani, Jelena Bontic dhe Hykmete Bajrami.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sami Kurteshi, Avokat i Popullit, Jashar Kastrati, Drejtor Ekzekutiv në IAP, Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashuriye Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 22.08.2011, 24.08.2011, 26.08.2011 dhe 29.08.2011;**
3. **Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010, I ftuar: Sami Kurteshi, Avokat i Popullit të Republikës së Kosovës;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-49 për zjarrfikje dhe shpëtim, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës;**
5. **Shqyrtimi i raportit me rekomandime i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Hasime Krasniqi, kërkoi sqarime për pikën e gjashtë të rendit të ditës që ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, përderisa është shqyrtuar në komision ky projektligj.

Kryetarja, sqaroi se bëhet fjalë për amendamentimin e këtij projektligji dhe formimin e një grupi punues që të merret më hollësisht me këtë çështje.

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit më datën 22.08.2011, 24.08.2011, 26.08.2011 dhe 29.08.2011

Kryetarja, sqaroi se në procesverbalin e mbledhjes së datës 22.08.2011 nuk ka qenë e mundur të përshkruhet diskutimi i deputetes Duda Balje për shkak të incizimit të dobët dhe kërkoi nga ajo që të konsultohet me administratën dhe të plotësohet diskutimi.

Procesverbalet miratohen me këtë plotësim.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010

Kryetarja, theksoi që raporti është i përmbledhur dhe kërkoi që këtij raporti t'i bashkangjitet një detalizim për mënyrën se si ka shkuar rrjedha e shpenzimeve.

Jashar Kastrati, informoi që në fillim të vitit kur është ndarë buxheti, Ministria e Financave ka bërë shkurtim prej 5% në mallra dhe shërbime dhe afër 5.000 € në paga dhe mëditje. Shpenzimet themelore kanë qenë për paga dhe mëditje në vlerë prej 271.424 €. Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur një buxhet prej donatorëve rreth 80.000 € për projektet që kanë qenë për vitet 2005, 2006 dhe 2007, i cili nuk është shpenzuar, por me kërkesë të Institucionit është riaktivizuar në vitin 2010 për nevoja të papërcaktuara. Ka pasur edhe donacione të reja prej UNICEF-it rreth 8.000 €, gjithashtu kemi pasur donacione edhe prej institucioneve vendore.

Hasime Krasniqi, shprehu pakënaqësinë lidhur me të dhënat financiare, të cilat janë të pamjaftueshme për ta bërë një vlerësim të raportit. Kërkoi që raporti të sillet në mënyrë më të kompletuar me të dhëna më të detalizuara.

Xhevdet Neziraj, theksoi që nga raporti financiar, por edhe nga raporti i auditmin vërehet se ka nevojë të punohet më tepër, të rritet kapaciteti i menaxhimit të financave dhe të përgatiten raportet në mënyrë më analitike dhe sintetike. Sugjeroi që në të ardhmen raportet dhe shpenzimet të paraqiten ashtu siç kërkohen me ligj.

Sali Asllanaj, sugjeroi që të jenë më të kujdesshëm në planifikim, në mënyrë që të kenë mjete të mjaftueshme për të realizuar veprimtarinë e tyre.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

I. I rekomandohet Kuvendit miratimin e Raportit vjetor financiar për vitin 2010 i

Institucionit të Avokatit të Popullit.

- II. Institucioni i Avokatit të Popullit të dorëzojë një raport plotësues financiar, i cili do të bashkangjitet këtij rekomandimi.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri

Kryetarja, njoftoi që në këtë Projektligj është paraparë shtimi i numrit të punëtorëve për komunat e reja që do të themelohen, mirëpo kjo çështje mbetet në rrjedhën e proceseve. Me këtë projektligj parashihet edhe një sistem i centralizuar i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, i cili kërkon bartjen e mjeteve nga nivelet komunale në nivelin qendror. Mirëpo, nëse analizohet projektligji në përgjithësi nuk përmban implikime buxhetore. Propozoi që në nenin 24, paragrafi 1 të ndryshohet si në vijim: “Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njësitë profesionale zjarrfikëse kalojnë në kuadër të Ministrisë, përkatësisht agjencisë, së bashku me stafin, buxhetin dhe pajisjet ekzistuese.”

Sali Asllanaj, kundërshtoi për shkak së bartja e kompetencave nga niveli lokal në atë qendror nuk është e dobishme dhe astete të mbeten në pronësi të komunave.

Hasime Krasniqi, propozoi që të hiqet fjala “pajisjet ekzistuese” dhe të mbetet vetëm stafi dhe buxheti, pasi që asetet janë investim vetanak i komunave.

Albana Fetoshi, propozoi që fjala “kalojnë” të zëvendësohet me fjalën “funksionojnë”.

Latif Gashi, propozoi që të mos ndryshohet amendamenti dhe të mbetet ashtu siç është në projektligj.

Komisioni me tetë vota Për, një votë kundër (Sali Asllanaj) dhe asnjë abstenim nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i grupit punues për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-09 për Financat e Pushtetit Lokal

Kryetarja, theksoi që nga vizitat që i ka bërë grupi punues nëpër disa komuna është vërejtur që Ligji për Financat e Pushtetit Lokal në përgjithësi implementohet nëpër komuna, mirëpo vërejtjet kryesore kanë qenë në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Komunitat e vizituara i kanë rregulloret e nxjerrura, edhe pse ato nuk janë krejtësisht identike me mënyrën e pagesës, sepse ka pasur ndryshime në tarifat e pagesës për shërbimet që kryhen. Ka pasur vërejtje edhe te bartja e kompetencave dhe grupi punues i ka nxjerrur disa rekomandime të cilat duhet të miratohen në komision.

Muhamet Mustafa, ngriti çështjen lidhur me transparencën e aprovimit dhe shpenzimit të buxhetit, pasi që qytetarët nuk janë edhe aq të informuar për buxhetet e komunave si dhe nuk janë pjesëmarrës në dëgjimet publike që mbahen lidhur me këtë çështje. Komunitat nuk janë të interesuara në mbledhjen e mjeteve vetanake dhe po dështojnë në mbledhjen e mjeteve nga tatimet, taksat komunale dhe kontributet, ato kryesisht janë të orientuara në mbledhjen e granteve, përderisa

buxhetet e tyre duhet të bazohen në fondet vetanake. Kërkoj që raporti të zgjerohet me arsyetimin se pse komunat po ngecin në zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryetarja, theksoi që këto çështje të cilat janë të parapara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, duhet të jenë pjesë e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, sepse nëse kërkohet që të ketë një transparencë më të madhe, atëherë mund të kërkojmë vetëm për të hyrat në bazë të atyre rregulloreve të nxjerrura, sepse mënyra e shpenzimit të mjeteve komplet rregullohet me Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Në raport është paraqitur një rekomandim që në bashkëpunim me komuna të krijohet një mekanizëm unik në planifikimin e të hyrave vetanake.

Sali Asllanaj, theksoi se është absurde që komunat të kenë autonomi lokale më të fuqishme, pasi që 90 % sigurohet nga niveli qendror, përveç Prishtinës e cila e ka mbi 80 % . Pjesëmarrja e qytetarit nëpër dëgjimet publike lidhur me buxhetet e komunave është vështirë të krijohet për një moment, mirëpo në kuadër të këtij ligji ka qenë e vështirë të rregullohen këto çështje, sepse ky ligj kryesisht ka të bëjë me burimet e të ardhurave të buxheteve komunale.

Kryetarja, propozoi që rekomandimi i fundit, i cili ka të bëjë me evidentimin dhe ruajtjen e pronave komunale të përmirësohet me propozimin që e dha deputeti Muhamet Mustafa lidhur me angazhimin më të madh në rritjen dhe transparencën e të hyrave vetanake.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Miratohet Raporti me rekomandime i grupit punues për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-09 për Financat e Pushtetit Lokal, me plotësimet e propozuara dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë plenare.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike

Kryetarja, theksoi se për Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike është bërë vërejtje në Raportin e Progresit dhe kërkoj që të merret një përgjigje nga administrata e Kuvendit se a mund të ndërhyjë komisioni në pjesët tjera të ligjit, apo vetëm në plotësim ndryshimet që kanë ardhur në komision.

Daut Beqiri, theksoi që nuk ka dispozita të posaçme ligjore me të cilat është rregulluar çështja e ndërhyrjes apo amendamentimit të dispozitave të ligjit bazik në procedurën e shqyrtimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Projektligjit. Ndërhyrjet eventuale të komisionit që me amendamente të bëjë ndryshime dhe plotësime të tekstin bazik të ligjit, nuk janë shprehimisht të ndaluara, përveç nëse ato kanë të bëjnë me natyrën dhe qëllimin e ndryshimeve të parapara në Projektligj. Gjithashtu, për të gjitha propozimet për ndryshim të ligjit bazik, duhet të kërkohet edhe mendimi i propozuesit të Projektligjit, pra Qeverisë.

Latif Gashi, kërkoj që përgjigja të jepet më detalisht dhe në mënyrë më zyrtare, sepse është një çështje shumë e ndieshme dhe me interes.

Kryetarja, theksoi që për ligjet që kërkohen me Raportin e Progresit ka sugjerime që të mos ketë ndërhyrje, sepse janë harmonizuar me Komisionin Evropian. Shprehu vërejtje që nuk ka logjikë që

raporti i partive politike t'i dërgohet auditorit, por raporti dërgohet në KQZ dhe pastaj Zyra e Auditorit Gjeneral bën auditimin e KQZ-së, duke përfshirë edhe raportet e partive politike.

Komisioni një zëri, formoi grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, në përbërje me:

1. Xhevdet Neziraj – raportues i grupit
2. Sali Asllanaj – anëtar
3. Latif Gashi – anëtar
4. Muhamet Mustafa – anëtar
5. Duda Balje – anëtare
6. Albana Fetoshi – anëtare

7. Të ndryshme

7.1. Kryetarja njoftoi me kërkesën e përfaqësueseve të Bankës Botërore për realizimin e një takimi më datën 08.09.2011 ora 13:00, me disa anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa, përkatësisht me Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Albana Fetoshi, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj, për të biseduar për Projektin që mbështet nga Banka Botërore për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturës së tregut financiar.

7.2 Kryetarja njoftoi për dy takimet e organizuara nga GIZ, në të cilat janë të ftuar anëtarët e Komisionit që të marrin pjesë më datën 07.09.2011 ora 16:00 dhe 08.09.2011 ora 09:00 në ndërtesën e GIZ-it, lidhur me konsolidimin e buxhetit dhe buxhetimin në aspektin gjinor.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj